- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_**

**Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_**

**Vula \_\_\_\_\_**

**Shtojca 8/1**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE  
LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

## Shtojca 9

### **LOTI I Nafte 10 ppm ULSD**

#### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme



## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);
- b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1;
- c. Sigurimin e ofertës, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 4;
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
- d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 8/1;
- e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Ky kriter plotësohet referuar **kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1** e dokumentave standarde të tenderit të cilat mbështeten në nenin 46, të Ligjit Nr. 9643, datë 20/11/2006, “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe vërtetojnë se operatorët ekonomikë kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës.

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019) të paraqitura në autoritetet përkatëse.

2. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019 dhe 2020 nese ky informacion esht i mundur) nga data e zhvillimit të tenderit lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e së cilës duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se 40% të vleres së fondit limit të **Lotit të I-re** që prokurohet, perkatesisht **43.679.893 (dyzet e tre milion e gjshteqind e shtatedhjete e nente mije e teteqind e nentedhjete e tre)** lekë pa TVSH.

3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020 sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

4. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB.

### 2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera (realizuara) gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (vleres së fondit limit të Lotit të I-re) ose **43.679.893 (dyzet e tre milion e gjshteqind e shtatedhjete e nente mije e teteqind e nentedhjete e tre)** lekë pa TVSH.

- Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate.

- Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur vetëm faturën përkatëse tatimore ku të jetë shënuar data, shuma, sasia e mallrave të furnizuara, të nënshkruar nga të dyja palët.

**2.** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Autorizim/Licence për tregtim karburantesh me pakice, leshuar nga pushteti vendor, sipas adresave të stacioneve të shitjes me pakice të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

**3.** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakice, *ku në Durrës të jënë minimalisht 3 (tre) stacione shitje me pakice*, kjo vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate notoriale ose akt pronësie ose të jënë të pasqyruara në ekstraktin e QKB, etj). Këto stacione të jënë të pajisura me Autorizim/Licence leshuar nga pushteti vendor, leje mjedisore të tipit C, vërtetim teknik leshuar nga organet e miratuara të vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Certifikate e mbrojtjes nga Zjarri leshuar nga M.Z.SH, dhe Police sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri për distributorët e shitjes me pakice.

**4.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin në tender fletë analizat të lëshuar nga ISHTI për lotin që konkuron e cila duhet të jetë leshuar jo më parë se 60 ditë nga data e hapjes së procedurës së prokurimit.

**5.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të leshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka importuar dhe / ose tregëtuar karburante sipas standardeve të legjislationit Shqiptar, dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësive për vitin 2020.

**6.** Operatori ekonomik do të paraqesë certifikatat e mëposhtme:

- Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, të jetë e akredituar si dhe të jetë e vlefshme.
- Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 14001:2019 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, të jetë e akredituar si dhe të jetë e vlefshme.
- Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 45001:2018 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, të jetë e akredituar si dhe të jetë e vlefshme.

- Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik, çertifikatat e mësipërme duhet të zotërohen minimalisht nga drejtuesi i bashkimit të përkohshëm të operatorëve.

7. Subjekti ofertues duhet të paraqesë deklaratat si me poshte:

- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht në pistolette publike. *(Deklarate nga subjekti ofertues.)*
- Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nepermjet kartave elektronike të personalizuar, sipas adresave të kerkuara nga Autoriteti Kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë në të gjitha pikat e tij qytetin e Durrësit, me kartë elektronike të personalizuar me targën e cdo automjeti të autoritetit kontraktor, dhe/ose bot, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në momentin e lidhjes së kontrates.
- ***Bazuar në VKM Nr 561 datë 29.07.2016, “Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qeverisjes së përgjithshme“ Operoret ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nepermjet kartës elektronike.***
- ***Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasise të karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasise të karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.***
- ***Faqja e menaxhimit të karburanteve duhet të ofrojë edhe shërbimin për krijimin e strukturës piramidale në përputhje me strukturën piramidale të Autoritetit kontraktor, shërbimin e furnizimit me karburant nepermjet kartave elektronike, stikera (pulla) të cilat ngjiten në xhamin e automjetit dhe ofrojnë shërbimin e furnizimit me karburant vetëm për atë automjet për të eliminuar levizjen e mundshme të targave nga mjetit shtetëror drejt mjeteve private, si dhe shërbimin e dergimit të fotografive me anë të emailit për cdo furnizim të kryer të mjetit pranë stacionit të shitjes së karburanteve me pakicë me qëllim identifikimin e mjetit dhe përdoruesit të saj .***
- ***Disponimi /Ekzistenca e faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), se bashku me ofrimin shërbimeve të kerkuara me sipër, do të demonstrohen nga ana e operatoreve ekonomike pjesëmarrës me shembuj për zbatimin në praktike, në prani anetareve të KVO-se të Autoritetit kontraktor përpara mbylljes së procesit të kualifikimit dhe shpalljes së fituesit.***
- ***Mos ofrimi i shërbimeve të kerkuara me sipër në mënyrë elektronike nepermjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron cdo operator ekonomik pjesëmarrës përben kusht për s'kualifikim.***

- **Shenim:** “Operatoret ekonomike qe do te ofertojne per më tepër se një Lot, duhet të kenë kapacitetet financiare dhe teknike sa shuma e loteve, për të cilat kanë ofertuar, te marra se bashku. Ne kete kuptim edhe kriteret e vecanta per kualifikim (Kontratat e ngjashme, xhiro, etj) duhet te plotesohen nga operatori ekonomik ne varesi te loteve qe ai konkuron”. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar ne përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kriteret e vendosura per lotet ku merr pjese, operatori ekonomik do të s’kualifikohet tek të gjitha lotet ku ka marrë pjesë”.

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

## **LOTI II Benzine Premium Unl 10 ppm**

### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaraten e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);*
- b. *Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1;*
- c. *Sigurimin e ofertës, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 4;*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 8/1;*
- e. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

Ky kriter plotësohet referuar **kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1** e dokumentave standarde të tenderit të cilat mbështeten në nenin 46, të Ligjit Nr. 9643, datë 20/11/2006, “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe vërtetojnë se operatorët ekonomikë kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**1.** Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019) të paraqitura në autoritetet përkatëse.

**2.** Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019 dhe 2020 nëse ky informacion është i mundur) nga data e zhvillimit të tenderit lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e së cilës duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit të **Lotit të II-te** që prokurohet, perkatesisht **462.733 (katerqind e gjashtedhjetë e dy mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre)** lekë pa TVSH.

**3.** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020 sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

4. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB.

### 2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera (realizuara) gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (vlerës së fondit limit të Lotit të II-te) ose **462.733 (katerqind e gjashtedhjetë e dy mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre)** lekë pa TVSH.

- Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate.

- Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur vetëm faturën përkatëse tatimore ku të jetë shënuar data, shumë, sasia e mallrave të furnizuara, të nënshkruar nga të dyja palët.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Autorizim/Licence për tregtim karburantesh me pakice, lëshuar nga pushteti vendor, sipas adresave të stacioneve të shitjes me pakice të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakice, *ku në Durrës të jënë minimalisht 3 (tre) stacione shitje me pakice*, kjo vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate noteriale ose akt pronësie ose të jënë të pasqyruara në ekstraktin e QKB, etj). Këto stacione të jënë të pajisura me Autorizim/Licence lëshuar nga pushteti vendor, leje mjedisore të tipit C, vërtetim teknik lëshuar nga organet e miratuara të vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Certifikate e mbrojtjes nga Zjarri lëshuar nga M.Z.SH, dhe Police sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri për distributorët e shitjes me pakice.

4. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin në tender fletë analizat të lëshuar nga ISHTI për lotin që konkuron e cila duhet të jetë lëshuar jo më parë se 60 ditë nga data e hapjes së procedurës së prokurimit.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka importuar dhe / ose tregëtuar karburante sipas standarteve të legjislativës Shqiptar, dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësive për vitin 2020.

6. Operatori ekonomik do të paraqesë certifikatat e mëposhtme:

- Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Certifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, të jetë e akredituar si dhe të jetë e vlefshme.

- Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 14001:2019 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, të jetë e akredituar si dhe të jetë e vlefshme.
- Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 45001:2018 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, të jetë e akredituar si dhe të jetë e vlefshme.
- *Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik, çertifikatat e mësipërme duhet të zotërohen minimalisht nga drejtuesi i bashkimit të përkohshëm të operatorëve.*

7. Subjekti ofertues duhet të paraqesë deklaratat si me poshte:

- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht në pistolette publike. *(Deklarate nga subjekti ofertues.)*
- Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nepermjet karteve elektronike të personalizuar, sipas adresave të kerkuara nga Autoriteti Kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë në të gjitha pikat e tij qytetin e Durrësit, me karte elektronike të personalizuar me targën e cdo automjeti të autoritetit kontraktor, dhe/ose bot, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në momentin e lidhjes së kontrates.
- ***Bazuar në VKM Nr 561 datë 29.07.2016, “Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qeverisjes së përgjithshme“ Operoret ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nepermjet kartes elektronike.***
- ***Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasise së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasise së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.***
- ***Faqja e menaxhimit të karburanteve duhet të ofrojë edhe shërbimin për krijimin e struktureve piramidale në përputhje me strukturën piramidale të Autoritetit kontraktor, shërbimin e furnizimit me karburant nepermjet kartave elektronike, stikera (pulla) të cilat ngjiten në xhamin e automjetit dhe ofrojnë shërbimin e furnizimit me karburant vetëm për atë automjet për të eliminuar levizjen e mundshme të targave nga mjetit shtetëror drejt mjeteve private, si dhe shërbimin e dergimit të fotografive me anë të emailit për cdo furnizim të kryer të mjetit pranë stacionit të shitjes së karburanteve me pakicë me qëllim identifikimin e mjetit dhe perdoruesit të saj.***
- ***Disponimi /Ekzistenca e faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), së bashku me ofrimin shërbimeve të kerkuara me sipër, do të demonstron nga ana e operoreve ekonomike pjesëmarrës me shembuj për zbatimin në praktike, në prani anetareve të***

*KVO-se se Autoritetit kontraktor perpara mbylljes se procesit te kualifikimit dhe shpalljes se fituesit.*

- *Mos ofrimi i sherbimeve te kerkuara me siper ne menyre elektronike nepermjet Faqes se menaxhimit te karburanteve (webpage), qe ofron cdo operator ekonomik pjesemarrës perben kusht per s'kualifikim.*
- **Shenim:** *“Operatoret ekonomike qe do te ofertojne per më tepër se një Lot, duhet të kenë kapacitetet financiare dhe teknike sa shuma e loteve, për të cilat kanë ofertuar, te marra se bashku. Ne kete kuptim edhe kriteret e vecanta per kualifikim (Kontratat e ngjashme, xhiro, etj) duhet te plotesohen nga operatori ekonomik ne varesi te loteve qe ai konkurron”. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar ne përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kriteret e vendosura per lotet ku merr pjese, operatori ekonomik do të s'kualifikohet tek të gjitha lotet ku ka marrë pjesë”.*

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

## **Shtojca10**

*[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]*

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

**ALBANAIN STANDARD  
AL ST EN 590:2013 + A1 :2017**

**Liquid Fuel for Vehicles -Gasoline  
Diesel-Requirements and Test Methods**



**Automotive fuels-Diesel-Requirements and test methods**

**General Directorate of Standardization**

Address: Street “Mine Peza”, 143/3, Mailbox; 98, Tirana

TEL: +355 42 22 62 55; Fax:+355 4224 7177

E-mail: [info@dps.gov.al](mailto:info@dps.gov.al)

GDS

Reproduction is prohibited. The exclusive right to publish and sell the Albanian Standards rests with GDS.

**AL ST EN 590:2013 +A1:2017**

**EN 590:2013+A1:2017**

Tabela 1-kërkesat e përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provës për karburantet automotive

Substanca	Njësia matëse	Limitet (normat)		Metoda e provës (shih klauzolës 2)
		Minimum	Maksimumi	
Numri i Cetanit		51	-	EN ISO 5165 EN 15195 EN 16144
Indeksi Cetanit		46,0	-	EN ISO 4264
Densiteti në 15 gradë celsius	Kg/m <sup>3</sup>	820,0	845,0	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Hidrokarbure Polycyclic aromatike	% (m/m)	-	8,0	EN 12916
Përmbajtje squfuri	mg/kg	-	10,0	EN ISO 20846 EN ISO 20884 EN ISO 13032
Përmbajtje Mangani Deri 31-12-2013 Nga 01.01.2014 në vazhdim	mg/l	- -	6,0 2,0	Pr EN 16576
Pika e ndezjes	Gradë celsius	Mbi 55	-	EN ISO 2719
Karboni i mbetur (në 10%mbetje distilati)	% (m/m)	-	0,30	EN ISO 10370
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,010	EN ISO 6245

Dokumentat Standarde të Tenderit

Përmbajtja e ujit	mg/kg	-	200	EN ISO 12937
Kontaminimi total	mg/kg	-	24	EN 12662
Gërryerja e shiritit bakrit (3 orë në 50 gradë celsius)	Grada	Grupi 1		EN ISO 2160
Përmbajtja e Acidit të ngopur metil ester FAME	% (V/V)	-	7,0	EN 14078
Qëndrueshmëria e oksidimit	g/m <sup>3</sup> h	- 20	25 -	EN ISO 12205 EN 15751
Lubrifikimi, diametri i veshjes së mprehte (wsd 1,4) në 60 gradë Celsius	µm (micrometer)	-	460	EN ISO 12156-1
Viskoziteti në 40 gradë Celsius	Mm <sup>2</sup> /s	2,000	4,500	EN ISO 3104
Distilimi % (V/V) rafinimi në 250 gradë celsius % (V/V) rafinimi në 300 gradë Celsius 95 % (V/V) rafinimi në	% (V/V) % (V/V) Gradë celsius	85	Më pak se 65  360	EN ISO 3405 EN ISO 3924
Shënim: Kërkesat me Bold i referohen Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70 /EC (1), duke përfshirë amendamentet 2003/17/EC (2), 2009/30/EC (3) dhe 2011/63/EU (4).				
<ol style="list-style-type: none"> <li>a. Shih gjithashtu 5.7.1.</li> <li>b. Shih gjithashtu 5.7.4.</li> <li>c. Shih gjithashtu 5.7.2.</li> <li>d. Për qëllimet e këtij Standardi Evropian, hidrokarbonet policiklikë aromatikë janë caktuar si përmbajtja totale e hidrokarboneve aromatike më pak se përmbajtja e hidrokarboneve mono-aromatike, të dyja të përcaktuara në EN 12916.</li> <li>e. Shih gjithashtu 5.7.3.</li> <li>f. Shih gjithashtu 5.2.2.</li> <li>g. Shih gjithashtu 5.2.2. dhe Aneksi A.</li> <li>h. Investigimi i mëtejshëm për kontaminimin total në metodën e provës për përmirësimin e saktësisë, veçanërisht për prezencën e FAME, nën mbikëqytjen e CEN.</li> <li>i. FAME i përkojnë kërkesat e EN 14214, shih (3).</li> <li>j. Kur karburantet e naftës përmbajnë më shumë se 2 % (V/V) FAME , qëndrueshmëria e oksidimit të përcaktuar në EN 15751 është kërkesa për të.</li> <li>k. Për llogaritjen e indeksit të Cetanit 10%, 50 % dhe 90% (V/V) nevojiten gjithashtu pikat e RECOVERY.</li> <li>l. Limitet e distilimit në 250 gradë Celsius dhe 350 gradë Celsius janë përfshirë në tarifën e karburantit naftë të Doganave të përbashkëta të BE.</li> <li>m. EN ISO 3924 jep instruksione për konvertimin në ISO 3405-të dhëna ekuivalente. Shih gjithashtu 5.7.5.</li> </ol>				

**EN 228:2012 + A1 :2017 (E)**

15367, Pjesët 2 dhe 3 respektivisht (7,8). Një metodë përcaktimi për komponentët me zierje të lartë në benzinën pa plumb është nën zhvillim e sipër nga CEN.

**Më poshtë, Tabela 1- Kërkesa dhe metoda prove për benzinën pa plumb me përmbajtje oksigjeni maksimum prej 3.7% (m/m)**

Vetitë	Njësitë	Kufizimet		Metoda Testi <sup>a</sup> (Shih Referenca normative) 2.
		Min	Max	
Numër Oktani Kërkimi, RON		95,0		EN ISO 5164 b
Numër Oktani Makine, MON		85,0		EN ISO 5163 b
Përmbajtje plumbi	Mg/l		5,0	EN 237
Densiteti (në 15°C) c	Kg/m <sup>3</sup>	720,0	775,0	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Përmbajtje Sulfuri c	Mg/kg		10,0	EN ISO 13032 EN ISO 20846 EN ISO 20884
Përmbajtje manganezi d Deri 31-12-2013 Nga 01-01-2014	Mg/l		6,0 2,0	EN 16135 EN 16136
Qëndrueshmëria e oksidimit	Min.	360		EN ISO 7536
Përmbajtja e gomës ekzistente (solvent i larë)	Mg/100ml		5	EN ISO 6246
Rrip korrozioni bakri 3 h në 50 °C	Vlerësim	Klasi 1		EN ISO 2160
Dukshmëria e		I qartë dhe i ndritshëm		Inspektim vizual

- Përmbajtja e tipit të hidrokarbonit c	% (V/V)		18,0	EN 15553 EN ISO 228 54
- Olefinë				
- Aromatik			35,0	
Përmbajtja e benzolit c	% (V/V)		1,00	EN 238 EN 12177 EN ISO 22854
Përmbajtja e oksigjenit c	% (m/m)		3,7	EN 1601 EN 13132 EN ISO 22854
Përmbajtja e oksigjenatit c	% (V/V)			EN 1601 EN 13132 EN ISO 22854
- Methanol g			3,0	
- Etanol h			10,0	
- Alkool Iso-propil			12.0	
- Alkol Iso-butyl			15.0	
- Alkool Tert-butyl			15.0	
- Eterë (5 ose më shumë atome C)			22.0	
- Oksigjenate të tjera			15.0	

SHËNIM: Kërkesat e theksuara me **bold** i referohen Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70/EC (1) duke përfshirë amendamentet në vijim (2), (3) dhe (4)

(a) Shih gjithashtu 5.7.1

(b) një korrekim i 0,2 për MON dhe RON do të zbritet për përlogaritjen e rezultatit final përpara raportimit sipas kërkesës së Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70/EC (1) duke përfshirë amendamentet në vijim (2), (3) dhe (4). Shih gjithashtu 5.6 dhe 5.7.2

(c) Shih gjithashtu 5.7.2

(d) Shih gjithashtu 5.3.3

(e) Dukshmëria do të përcaktohet në temperaturë ambienti

(f) Një studim CEN gjendet në EN ISO 22854 i aplikueshëm për analizat e mostrave që kanë një përmbajtje oksigjeni prej maksimumi 3.7% (m/m).

(g) Do të shtohen agjentë stabilizues

(h) Kur përdoret etanoli si komponent përzjerjeje do të bëhet në përshtatje me EN 15376 (Shih 5.1). Agjentë stabilizues mund të shtohen.

(i) të tjera monoalkoolike dhe eterë me një pikë zierjeje të fundit jo më të lartë se sa

përshkruhet në Tabelën 3

(k) Metodatat e cituara të testit nuk kanë një parashtrësë precizioni për një përmbajtje oksigjeni mbi 3 (m/m). Bazuar në të dhëna kompeticioni nga gjashtë vjetët e fundit, CEN/TC 19 pranon një vlerë riprodhimi mesatare të  $R=0.37$  për të gjitha metodatat e testit.

**Në vijim, Tabela 2- Kërkesa dhe metoda testi për benzinën pa plumb me përmbajtje oksigjeni maksimum prej 2.7% (m/m)**

Dokumentat Standarde të Tenderit

Vetitë	Njësitë	Kufizimet		Metoda Testi <sup>a</sup> (Shih Referenca normative) 2.
		Min	Max	
Numër Oktani Kërkimi, RON		95,0		EN ISO 5164 b
Numër Oktani Makine, MON		85,0		EN ISO 5163 b
Përmbajtje plumbi	Mg/l		5,0	EN 237
Densiteti (në 15°C) c	Kg/m <sup>3</sup>	720,0	775,0	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Përmbajtje Sulfuri c	Mg/kg		10,0	EN ISO 13032 EN ISO 20846 EN ISO 20884
Përmbajtje manganazi d Deri 31-12-2013 Nga 01-01-2014	Mg/l		6,0 2,0	EN 16135 EN 16136
Qëndrueshmëria e oksidimit	Min.	360		EN ISO 7536
Përmbajtja e gomës ekzistente (solvent i larë)	Mg/100ml		5	EN ISO 6246
Rrip korrozioni bakri 3 h në 50 °C	Vlerësim	Klasi 1		EN ISO 2160
Dukshmëria e		I qartë dhe i ndritshëm		Inspektim vizual
- Përmbajtja e tipit të hidrokarbonit c - Olefinë - Aromatik	% (V/V)		18,0 35,0	EN 15553 EN ISO 228 54
Përmbajtja e benzolit c	% (V/V)		1,00	EN 238 EN 12177 EN ISO 22854
Përmbajtja e oksigjenit c	% (m/m)		2,7	EN 1601 EN 13132 EN ISO 22854

Përmbajtja e oksigjenatit c - Methanol - Etanol g	% (V/V)		3,0 5,0	EN 1601 EN 13132 EN ISO 22854
- Alkool Iso-propil h - Alkol Iso-butyl h - Alkool Tert-butyl h - Eterë (5 ose më shumë atome C) h - Oksigjenate të tjera hi			Përzierje volumi e kufizuar në 2.7% (m/m) përmbajtja max. e oksigjenit	
SHËNIM: Kërkesat e theksuara me <b>bold</b> i referohen Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70/EC (1) duke përfshirë amendamentet në vijim (2), (3) dhe (4)				
(a) Shih gjithashtu 5.7.1 (b) një korrektim i 0,2 për MON dhe RON do të zbritet për përlogaritjen e rezultatit final përpara raportimit sipas kërkesës së Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70/EC (1) duke përfshirë amendamentet në vijim (2), (3) dhe (4). Shih gjithashtu 5.6 dhe 5.7.2 (c) Shih gjithashtu 5.7.2 (d) Shih gjithashtu 5.3.3 (e) Dukshmëria do të përcaktohet në temperaturë ambienti (f) Do të shtohen agjentë stabilizues (g) Kur përdoret etanoli si komponent përzierjeje do të bëhet në përshtatje me EN 15376 (Shih 5.1). Agjentë stabilizues mund të shtohen. (h) Përmbajtja e oksigjenit të benzinës së pastër pa plumb nuk do të kapërcej 2,7% (m/m). Një CEN/TR mbi përzierjen oksigjenate është në përgatitje e sipër. (i) të tjera monoalkoolike dhe eterë me një pikë zierjeje të fundit jo më të lartë se sa përshkruhet në Tabelën 4				

**Shtojca11**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>	_____	_____
<b>02</b>	_____	_____
<b>03</b>	_____	_____
<b>...</b>	_____	_____



## **Shtojca 12**

*( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### **SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

**Afatet e lëvrimit:**

**Shtojca 13**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>4</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

---

<sup>4</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

## Shtojca 14

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

\* \* \*

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

\* \* \*

[ Titullari i autoritetit kontraktor]

## Shtojca 15

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyt e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj.\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## Shtojca 16

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat – Tender i Hapur**

#### **Neni 1: Qellimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi,

- tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikrat e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.



### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6: Pronësia Intelektuale**

